



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 25 nëntor 2015, në mbledhjen e XXIII-të (njëzetetë) të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë këshilltarët e Kuvendit, përveç z.Hasan Softollit i cili mungoi.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe, z.Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive komunale, z.Muharrem Haziri përfaqësues i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i qytetarëve.

1. Miratimi i rendit të ditës

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, përshëndeti të pranishmit, ndër të tjera shtoi, konsideroj se rendi i propozuar i ditës dhe materiali përkatës u është dërguar me kohë, po ashtu rekomandimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa u janë dhënë në hyrje të kësaj mbledhjeje sipas së cilit duhet të bëhet betimi i një këshilltari të ri të Kuvendit të Komunës si dhe një pikë shtesë e cila i është rekomanduar Kuvendit për shqyrtim në kuadër të pikës së katërt të rendit të ditës, dhe atë;

- **Propozimi i Vendimit për ndërrim të destinimit të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore sipas kërkesës së Hazir Mehmet Sylës nga fshati Gllamnik**

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, dëshiroj të bëjë një deklaram, sigurisht jeni në dijeni se para disa ditësh strukturat politike të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në Podujevë kanë marrë një vendim që të shuajnë aktivitetin politik në këtë subjekt në Podujevë, dhe ne i'u kemi bashkëngjitur Partisë Demokratike të Kosovës, kështu që rrjedhimisht edhe unë si pjesë e asaj strukture, duke respektuar vendimet e kolegëve, deklaroj se nga sot i bashkëngjitem Grupit të këshilltarëve të Partisë Demokratike të Kosovës.

znj.Mrika Thaqi, theksoi, unë sot me vete e kam Ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit e datës 21 shkurt 2014 dhe dëshiroj të citoj fjalët e z.Lutfi Rexhepit,

zonja Thaqi e shfrytëzoi të drejtën e saj ligjore që mandatin e vet të trajtoj si të pavarur, mirëpo në fakt veprimi i cekur e zbeh përfaqësimin në Kuvend por nuk e zbeh forcën politike të AAK-së e cila në zgjedhjet e fundit lokale ka marr 9% të votave nga elektorati i Komunës së Podujevës, Unë në cilësinë e bartësit të listës i kam 3153 vota dhe nëse z.Mrika Thaqi i bartë votat e veta, votat e mia nuk mund t'i bartë.

Andaj zotëri Rexhepi edhe nëse i bartë 3153 votat tua aty ku ke shkuar, falë të qofshin, por jo që e ke zbeh Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës në Podujevë, përkundrazi e ke liruar nga ngulfatja që e pati bërë.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kalimi në Grupe të tjera të subjekteve politike është e drejtë e këshilltarëve, dhe në këtë aspekt z.Lutfi Rexhepit i dëshiroj suksese në punë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, në mbledhjen e KPF-së, në një formë me shumicë të votave i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim ngase vetëm një pikë e rendit të ditës ka qenë si më e rëndësishme e cila është raporti financiar, kurse propozimet e vendimeve për ndërrim të destinimi të tokës tani veç janë bërë të përhershme që secili pronar i tokës ka të drejtë të shfrytëzoj pronën e vet ashtu siç dëshiron ai.

Mora fjalën me qëllim të ngritjes së një çështje e cila ka të bëjë me Drejtorinë e Arsimit ku sipas një vendimi që e posedoj unë thuhet se është dorëzuar në Kuvendin komunal dhe në Drejtorinë e Arsimit nga Departamenti i Inspeksionit të MASHT-it, më 02.10.2015, dokument i cili nuk ka ardhur në KPF dhe Kuvend në mënyrë që ta shqyrtojmë atë vendim të Inspeksionit të arsimit i cili ka të bëjë me largimin politik të znj.Shukrije Zhitijes nga vendi i punës, vendim për të cilin mendoj se është dashur të merret drejtori aktual ose ish drejtori z.Nexhmi Rudari, e po ashtu mendoj se është dashur të merret edhe Kryesuesi i Kuvendit sepse sigurisht se e posedon dhe është dashur ta bie në KPF dhe Kuvend për shqyrtim. Në këtë vendim thuhet, Drejtoria komunale e Arsimit në Podujevë, menjëherë të angazhoj znj.Shukrije Zhitijen, mësimdhënëse e lëndës praktike profesionale në shkollën “Fan S Noli” , me arsyetimin se inspektorët e arsimit bazuar në inspektimin special të realizuar më 03.12.2014 në Drejtorinë e Arsimit dhe në shkollën përkatëse kanë konstatuar se ndaj znj.Shukrije Zhitijes është bërë shkelje, me procesverbalin nr.298/12 të datës 08.12.2014, inspektori ka rekomanduar Drejtorinë e Arsimit në Podujevë që menjëherë ta anuloi vendimin për mësimdhënësin e angazhuar kurse në vend të tij të angazhoj znj.Shukrije Zhitijen. Pra unë nuk mora fjalën të kërkoj që kjo çështje të futet në rend të ditës apo të flas politikisht, por për një mësimdhënëse e cila me ligj e ka fituar të drejtën të kthehet në vendin e punës dhe e ka nxjerrë si shkelës të ligjit ish drejtorin e Drejtorisë së Arsimit zotëri Rudarin dhe drejtorin aktual zotëri Malokun i cili nuk është duke u marrë me këtë rast, konsideroj se do të ishte mirë të merremi me këtë çështje dhe kërkoj nga Drejtoria e Arsimit që të zbatoj vendimin e Inspeksionit të arsimit ose në të kundërtën ne si Grup politik pa dashjen tonë do të gjejmë formën legale për zbatimin e atij vendimi.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me çështjen e ngritur nga parafolësi, konsideroj se kjo çështje është dashur të paraqitet në pikën, të ndryshme, ndërsa lidhur me referimin që e bëri parafolësi se Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e ka poseduar një shkresë apo vendim të tillë, ju them se unë nuk kam pasur kurrfarë shkrese për këtë çështje për të cilën mendoj se i përket Ekzekutivit të Komunës e jo Kuvendit të Komunës, kështu që kjo le të mbetet si pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit që në

një mbledhje të ardhshme të jap përgjigje. Andaj e hedh në votim rendin e propozuar të ditës së bashku me rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës duke përfshirë edhe konstatimet e Komitetit për Politikë dhe Financa përkatësisht;

-Zëvendësimi i një anëtari të Komisionit për verifikimin e mandateve të këshilltarëve të Kuvendit, njëkohësisht edhe dhënia e betimit të z.Ruzhdi Fazliut, në cilësinë e këshilltarit të Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Gjithashtu në kuadër të pikës së pestë të rendit të ditës të përfshihet edhe pika shtesë, -Propozimi i Vendimit për ndërrim të destinimit të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore sipas kërkesës së Hazir Mehmet Sylës nga fshati Gllamnik.

- **Verifikimi i Mandatit dhe dhënia e betimit të Këshilltarit të Kuvendit**

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, para se të kalojmë me pikën e dytë të rendit të ditës ju njoftoj se z.Ruzhdi Fazliu nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës është certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve këshilltar i Kuvendit të Komunës së Podujevës në vend të z.Afrim Shabanit ish këshilltarë i Kuvendit i cili është tërhequr nga cilësia e këshilltarit të Kuvendit për shkak të angazhimit në detyrë të re si Ushtrues i Detyrës së drejtorit të QKMF-së në Podujevë. z.Afrim Shabani ka qenë edhe anëtar i Komisionit për verifikimin e mandateve të këshilltarëve të Kuvendit, andaj është e nevojshme të propozohet një anëtar nga radhët e subjektit LDK, për anëtar të komisionit të cekur.

z.Fidan Rekaliu, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, për anëtar të Komisionit për verifikimin e mandateve të këshilltarëve të Kuvendit, propozoj z.Bahri Blakçorin.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, nënvizoi, ju rikujtoj se në kuadër të këtij komisioni janë, z.Flakron Gashi – PDK, dhe z.Haki Rudari – LVV .

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozimi i z.Fidan Rekaliu që në vend të z.Afrim Shabanit, në Komisionin për verifikimin e mandateve të Kuvendit të Komunës, të jetë z.Bahri Blakçori.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, pas konstatimit të përbërjes së komisionit përkatës i ftoj anëtarët e komisionit për verifikimin e mandatit të z.Ruzhdi Fazliut, këshilltari i ri i certifikuar me Vendim nga ana e KQZ-së, dhe njëkohësisht paraqitjen e raportit.

z.Flakron Gashi, Në emër të Komisionit për verifikimin e mandateve të këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, nënvizoi, ne si Komision konstatuam, duke u bazuar në Vendimin e Komisionit Qendrorë Zgjedhorë nr. 877-2015 të datës 19 nëntor 2015, se nga sot z.Ruzhdi Fazliu emërohet anëtar i Kuvendit të Komunës në Podujevë nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës duke zëvendësuar anëtarin e Kuvendit të Komunës z.Afrim Shabani, sa për korrektësi dua të lexoj edhe arsyetimin e Vendimit përkatës ku thuhet, KQZ pas shqyrtimit të kërkesës së Kryesuesit të Kuvendit të Komunës në Podujevë të datës 13 nëntor 2015, nr. 861/2015 për zëvendësimin e anëtarit

të Kuvendit të Komunës z.Afrim Shabani, pas dorëheqjes së parevokueshme të tij nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës për arsye të ushtrimit të detyrës së drejtorit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Podujevë. Duke u bazuar në deklaratën për pranimin e mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së renditur, i cili është z.Ruzhdi Fazliu nga i njëjti subjekt politik, gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave sipas rezultateve të certifikuara të zgjedhjeve lokale të vitit 2013 dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën 1 të këtij vendimi.

Në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e PDK-së, z.Ruzhdi Fazliut i dëshirojmë sukses, gjithashtu edhe në emër të Komisionit.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, fillimisht ia rikujtoj z.Ruzhdi Fazliut procedurat e dhënies së betimit dhe e ftoj atë të përgatitet për dhënien e betimit solemn.

Pas përfundimit të procedurave të dhënies së betimit, Kryesuesi i Kuvendit konstaton se nga tani zyrtarisht z.Ruzhdi Fazliu është këshilltar i Kuvendit të Komunës së Podujevës.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, nënvizoi, urime tani zyrtarisht jeni këshilltarë të Kuvendit të Komunës së Podujevës.

2. Shqyrtimi i Ekstrakteve të procesverbaleve të mbajtura në mbledhjet e Kuvendit më 10 shtator 2015 (mbledhje e jashtëzakonshme), 30 shtator 2015, dhe 20 tetor 2015.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kemi tri Ekstrakte të procesverbaleve, andaj fillojmë me shqyrtimin e tyre sipas radhës.

z.Haki Rudari, theksoi, më 10.09.2015 kemi pasur një mbledhje të jashtëzakonshme me temë, Gjendja e arsimit në Komunën e Podujevës me theks të veçantë në shkollën e fshatit Halabak, mendoj se në fund të procesverbalit ku thuhet se “Kryesuesi e konstatoi mbledhjen të mbyllur”, ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e LVV-së mendojmë se mbledhja nuk ka përfunduar ashtu siç duhet të përfundoj. Neni 45.1 i Rregullores së Punës së Kuvendit ndër të tjera thotë, Kryesuesi i Kuvendit në konsultim me propozuesin e çështjes për të cilën debatohet apo çfarëdo konsultimesh tjera duhet të ketë një konsultim, andaj unë mendoj se ajo mbledhje është përfunduar në mënyrë jo të rregullt dhe mendoj se është bërë me qëllim për arsye se në fund të mbledhjes ne kemi pasur disa propozime të cilat kemi menduar t'i paraqesim dhe për të cilat kemi menduar se do të modifikohen dhe plotësohen nga të tjerët. Gjithashtu në këtë mbledhje por edhe në mbledhje të tjera kur po kemi të bëjmë me pikën, të ndryshme, nuk po përfundohet ashtu si duhet, andaj kërkoj që këtë çështje në të ardhmen mos të përsëriten për arsye sepse mendoj se po shkelet e drejta e këshilltarit të Kuvendit dhe rregullorja n'bazë të cilës ne jemi duke punuar. Po ashtu të njëjtën vërejtje e kam edhe për mbledhjen vijuese.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, parafolësi në atë mbledhje e ka paraqitur fjalën hyrëse, por që edhe tri-katër herë tjera ka marrë fjalën gjatë mbledhjes, dhe pasi kanë përfunduar diskutimet unë e kam mbyllur mbledhjen, të njëjtën kohë është kërkuar fjala nga parafolësi, kështu që konstatimi në procesverbal është ashtu dhe nuk mund të ndryshohet as për mua e as për parafolësin. Pra parafolësi bëri vërejtje në parim, kurse sa i përket Ekstraktit të procesverbalit nuk ka çka të bëhet vërejtje.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, tani jemi në pikën që ka të bëjë me shqyrtimin e procesverbaleve, mirëpo ne e kaluam një temë e cila ka të bëjë me ish këshilltarin e Kuvendit z.Afrim Shabani i cili ju ka përmbajtur procedurave të heqjes dorë nga cilësia e këshilltarit të Kuvendit gjë të cilën unë e respektoj, dhe këshilltarin e ri e uroj për mandatin, mirëpo mendoj se ne tani duhet ta rregullojmë çështjen e Komitetit për Politikë dhe Financa sepse z.Afrim Shabani ishte anëtarë i këtij Komiteti. Pra i nderuar Kryesues, mendoj se nuk mund ta plotësojmë përbërjen e Kuvendit të Komunë kurse në anën tjetër ta përgjysmojmë KPF-në. Udhëzimi Administrativ nr. 03/2014 për organizimin dhe funksionimin e Komiteteve të obliguara në Komunë e rregullon këtë çështje dhe Kryesuesi i Kuvendit është në dijeni shumë mirë për këtë sepse ne kemi pasur një takim rreth kësaj çështjeje dhe si solucion ka dalë që Kryesuesi është shkelës i këtij Udhëzimi por ka mbetur që kjo çështje të rregullohet, ose në të kundërtën këtë çështje do ta ngritim. Andaj i nderuar Kryesues i Kuvendit ju e keni dëmtuar buxhetin e Komunës për dy vite me mëditje për dy anëtarë më shumë në Komitet, andaj neve si Grup i këshilltarëve pa dashje na detyron të ngrisim një kallëzim penal dhe për këtë çështje unë në cilësinë e shefit të Grupit të këshilltarëve nga radhët e PDK-së në mbledhjen e radhës me rastin e përgatitjes së planit të punës do të kërkoj që përbërja e KPF-së të ndryshohet dhe për seancën e muajit dhjetor të jetë i gatshëm sepse nuk mund të vie ndonjë anëtar nga radhët e LDK-së në Komitetin për Politikë dhe Financa por duhet të hiqet edhe një anëtarë nga ky Komitet, pra të jemi të qartë, z.Afrim Shabani ka qenë këshilltar i Kuvendit dhe anëtar i KPF-së, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës është duke e mbajtur këtë komitet me 11 anëtar e këtë çështje ne jemi të obliguar të ia sqarojmë kurse ai nëse dëshiron mund ta zbatoj ose jo, neni 4 i Udhëzimit të cekur thotë, Kuvendi Komunal i cili përbëhet nga 35 deri në 41 këshilltarë, përbërja e KPF-së duhet të jetë prej 9 anëtarëve, e që ju si Kryesues i Kuvendit keni qenë në dijeni për këtë që nga fillimi i mandatit dhe keni qenë të obliguar ta zbatoni, kurse që dy vite KPF përbëhet prej 11 anëtarëve dhe Kryesuesi nuk e ka zbatuar Udhëzimin por e ka shkelur atë për dy vite me radhë.

Në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit që nga sot të filloj ta zbaton Udhëzimin Administrativ përkatës, në të kundërtën nëse në mbledhjen e radhën nuk zbatohet, unë personalisht do të ngris kallëzim penal për dëmtim të buxhetit dhe për përfitim pa bazë, ngase ne paguhemi nga të hyrat vetanake apo nga taksat që paguajnë qytetarët.

Pas votimit u konstatua se me 31 vota për, 3 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 10 shtator 2015.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kalojmë me shqyrtimin e Ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 30 shtator 2015.

z.Haki Rudari, theksoi, në faqen 23 të këtij ekstrakti ndër të tjera thuhet, “*pasi nuk pati të lajmëruar për diskutim Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj mbledhjen të mbyllur*”, mendoj se është shumë skandaloze, dhe është dashur që Kryesuesi i Kuvendit të reagoj, sepse znj.Adelina Stublla ka qenë në foltore dhe e cila nuk ka mundur të flas, andaj si të pranohet një procesverbal i tillë. Është mirë që jo vetëm ne si Grup por të gjitha Grupet e këshilltarëve të Kuvendit të reagojnë në situata të tilla, ngase një gjendje e njëjtë mund t'i

përsëritet edhe ndonjë këshilltari nga subjektet tjera, andaj mendoj se është mirë që këtë procesverbal ta kundërshtojmë tërësisht.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me çështjen që parafolësi e tha, dua t'ju sqaroj se pasi është përfunduar pika që ka qenë para pikës Të Ndeshme, shumica e këshilltarëve kanë filluar të dalin nga salla duke menduar se mbledhja përfundoj edhe pse unë kam bërë thirrje të ulen por nuk kanë dëgjuar nga zhurma dhe pastaj e kam vërejtur se nuk ka kuorum dhe e kam mbyllur mbledhjen, por sido që të jetë parafolësi e dha vërejtjen e tij dhe kjo regjistrohet. Andaj e hedh në votim këtë Ekstrakt të Procesverbalit.

Pas votimit u konstatua se me 31 vota për, 3 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 30 shtator 2015.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kalojmë me shqyrtimin e Ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 20 tetor 2015.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 20 tetor 2015.

3. Raporti financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar – shtator 2015

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ftoj drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave të japë fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës.

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, në fjalën hyrëse ndër të tjera nënvizoi, paraqitja e këtij raporti bëhet duke u bazuar në obligimin ligjor që kanë Komunitat. Raporti paraqet të hyrat dhe shpenzimet e Komunës për periudhën përkatëse sipas kodeve dhe kategorive buxhetore duke bërë edhe një krahasim të të gjitha shpenzimeve për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Shpenzimet e buxhetit për këtë periudhë kanë arritur shumën 12,261,365.00 €, duke specifikuar në mënyrë të detajuar të gjitha shpenzimet për secilën kategori buxhetore, e që në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2014 vërehet një rritje e shpenzimeve prej 11%. Inkasimit i të hyrave vetanake për këtë periudhë është 848,537.00 € ku në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kemi një zvogëlim prej 7.51%, zvogëlim ky i cili na bënë të mos ndihemi mirë por që mbetet që deri në fund të vitit të merremi më shumë me këtë çështje në mënyrë që inkasimi i të hyrave të jetë në nivelin e kënaqshëm, por kjo bëhet me një angazhim të përbashkët duke iu bërë apel të gjithë qytetarëve dhe bizneseve që t'i kryejnë obligimet e tyre ligjore ndaj Komunës në mënyrë që qytetarët dhe bizneset të kenë kushte më të mira për një jetë më të mirë respektivisht kushte më të mira për ushtrimin e bizneseve të tyre. Pra mund të konstatojmë se ky raport jep një pasqyrë të qartë të të hyrave dhe shpenzimeve të Komunës për periudhën janar-shtator 2015.

z.Fidan Rekalju, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të Kuvendit të Komunës nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përkrahim këtë raport financiar për periudhën janar-shtator 2015 dhe konsiderojmë se është në përputhje të plotë me ligjin dhe i cili

pasqyron shumë qartë të hyrat dhe të shpenzimet buxhetore të Komunës për periudhën përkatëse nëntë mujore të vitit 2015.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, vetë raporti është i tillë i cili paraqet gjendjen reale të cilën drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave e ka paraqitë dhe nuk i'u ka shmangur realitetit gjë për të cilën e falënderoj edhe për gjetjet që i ka përfshirë në këtë dokument të cilin ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës e kemi analizuar me vëmendje sidomos në pagesat që janë bërë për periudhën përkatëse, e që vlen të ceket se kemi rreth 50,000.00 €, pagesa të dhunshme sipas vendimeve gjyqësore për të cilat është dashtë të paguhen edhe 3,5% taksë mujore e atyre kontratave sepse kontratat gjithsesi duhet të paguhen, por nuk jam në dijeni se ato kontrata në cilën kohë është dashtë të paguhen ngase 3.5% deri në 10% duhet të paguhet kamata mujore si dhe taksa gjyqësore e aktvendimeve gjë për të cilën nuk mund të themi se jemi shumë mirë. Çështje tjetër të cilën e paraqet ky raport është edhe rënia e të hyrave jo vetëm sa i përket tatimit në pronë e cila ndoshta mund të jetë si rezultat i faljes së borxheve ashtu siç është paraqitë në raport, mirëpo ka rënie drastike e të hyrave vetanake në të gjitha fushat për të cilën mendoj se është një performancë shumë e dobët e kadastrit dhe e Drejtorisë së Inspeksionit e cila nuk ka qenë në krye të detyrës për inkasimin e mjeteve. Gjithashtu në këtë raport shohim pagesat e bëra për punëtorët me kontratë të cilët punojnë në shëndetësi dhe atyre në arsim çështje për të cilën nuk mund të kuptoj se me çfarë të drejte Drejtoritë përkatëse paguajnë punëtorë të cilët janë jashtë listës së pagave kur jemi në dijeni se sistemi i arsimit ka numrin e punëtorëve sipas listës zyrtare të Ministrisë, pra do të thotë se ky menaxhment i ka dëmtuar qytetarët sepse të gjitha të hyrat vetanake si ato të vitit 2014 rreth 159,000.00 € të cilat janë bartë në këtë vit për pagesa të ndryshme ashtu edhe të hyrat vetanake të vitit 2015, janë duke u paguar njerëz të cilët janë tepriçë në sistem. Është denigruar tej mase profili i arsimit sa që një profesor i të devotshëm të Gjeografisë dhe njërit të Historisë ja kanë dërguar katër konkurrent – kandidat politik, pa marrë parasysh nga cili subjekt, të cilëve u janë ndarë nga dhjetë orë dhe pagesat u janë bërë nga të hyrat vetanake, gjë ndodh vetëm në Komunën e Podujevës. Situatë e njëjtë është edhe në shëndetësi, ne të gjithë jemi deklaruar se inkasimi i mjeteve në muajin dhjetor të vitit 2014 kalon respektivisht bartet në vitin 2015, mirëpo i kemi mbi 1 milion euro të hyra vetanake, por nuk i kemi për të dërguar njerëz politik me kontratë dhe me bë pagesa nga ato të hyra, dhe shuma prej 159,000.00 € ka mund të destinohet në ndonjë fushë më emergjente, shembull, Kuvendi i Komunës ende nuk ka buxhet për të bërë ndonjë punë më efikase, apo Drejtoria përkatëse nuk ka buxhet të ndarë për raste emergjente si vërshime e të ngjashme. Pra raporti paraqet situatën e Komunës në të cilën gjendemi dhe mendoj se Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ja kanë humbur vlerën edhe vetë emërtimeve të këtyre Drejtorive ngase kemi të bëjmë me edukim dhe shëndet, dhe për këtë besoj se Kryetari i Komunës është në dijeni. Çështje tjetër e cila vlen të ceket është se në raportin e ardhshëm sigurisht se do të ceket edhe shpenzimi që është bërë për rrënimin e objektit të vjetër të shkollës “Naim Frashëri” ku oferta më lirë ka qenë rreth 16,000.00 € kurse tenderin e ka fituar një kompani me ofertë në shumë rreth 36,000.00 €, nuk jam në dijeni se kush mund të jetë ai person i cili eliminon ofertën me çmimin më të vogël kurse i humbë rreth 20,000.00 € me një nënshkrim, mirëpo mendoj se anëtarja e Kuvendit nga radhët e LVV-së ka propozuar në një seancë të mëparshme që ai objekt të shëndërrohet në një muze dhe kjo gjë besoj se do të mund të bëhej me 36,000.00 €.

Në raportin e ardhshëm e që besoj se do të përfshihet edhe shuma e mjeteve të shpenzuara për rrënimin e shkollës së cekur dhe besoj se shefi i Grupit të LDK-së prapë do të lavdëroj atë raport, mirëpo konsideroj se raportet e tilla duhet të shikohen realisht e jo politikisht. Çështje e njëjtë ka ndodhur edhe me pagesat e dhunshme sipas vendimeve të Gjykatave duke përfshirë edhe kamatat, mandej është një pagesë për ofertim nga Zyra e prokurimit sipas ofertës nr. 126 me vlerë në shumë të mesme, ndërsa nënshkrimi i kontratës nr.111 për lëndë djegëse është me vlerë më të madhe, lidhur me këtë mendoj se këtë zyrë duhet ta mbikëqyrë dikush, dhe besoj se Komiteti për Politikë dhe Financa në të ardhmen do të insistoj të zbatohet ligji sa i përket hartimit të planeve vjetore të Drejtorive dhe Zyrës së prokurimit, sepse të gjithë ne jemi të obliguar që ndaj këtyre shkelleve të reflektojmë, dhe nuk mund të kuptoj se çfarë profili i këshilltarëve jemi ne kur nuk merremi me çështje të cilat kanë të bëjnë me interesat e qytetarëve, siç ishte rasti i dhënies së tenderit në vlerë rreth 36,000.00 € dhe eliminimi i ofertuesit me vlerë rreth 16,000.00 €, apo çështja tjetër që kishte të bëjë me mjetet e bartura nga viti 2014 të cilat pastaj janë destinuar për pagesa të punëtorëve me kontratë në arsim dhe shëndetësi. Grupi këshilltarëve nga radhët e PDK-së nuk e sheh këtë raport nga këndi se a do të votohet apo jo, sepse raporti është kështu siç është dhe nuk mund të ndryshohet, mirëpo vërejtjet tona janë evidente dhe u ceken disa prej tyre. gjithashtu ky dokument është publik dhe duhet të publikohet në faqe zyrtare të Komunës në mënyrë që të mund të analizoj dhe vlerësoj secili qytetarë. Sa unë jam në dijeni Komuna e Podujevës është në krizë financiare dhe nëse nuk keqpërdoren të hyrat vetanake nuk do të mund të realizohen pagat, dhe vetëm në këtë muaj nga fondi i Komunës rreth 36,000.00 € janë marrë për rrënimin e objekti të vjetër të shkollës “Naim Frashëri”, kurse ne si Kuvend i Komunës me 35 këshilltarë diskutojmë për 3000.00 € të Kuvendit të Komunës për mallra dhe shërbime, duke pasur mospajtime mes veti se si dhe ku t'i shpenzojmë ato mjete.

z.Haki Rudari, theksoi, edhe unë do të filloj me gjendjen jo të kënaqshme në arsimin e Komunës së Podujevës, mendoj se kolegët mësimdhënës të cilët punojnë në shkollën e re të qytetit dhe në atë “Xheladin Rekaliu” janë në dijeni se si është gjendja në hyrje të këtyre dy shkollave të cilat janë shëndrruar në moçale apo kënetë si pasoj e menaxhimit të dobët, gjendje e cila tregon se si është duke punuar qeveria komunale. Sa i përket shkollës “Naim Frashëri” është e vërtetë se këshilltarja e Kuvendit znj.Adelinë Stublla e ka ngritur atë çështje dhe tani del se plotësisht ka qenë e arsyeshme, shkollë e cila ka 2 javë që mbi 1200 nxënës qëndrojnë në shtëpi, si pasoj e përsheptimit të rrënit të objektit të vjetër dhe si pasoj e neglizhencës së qeverisë komunale, andaj mendoj se duhet të ngritët zëri nga të gjithë këshilltarët e Kuvendit nga të gjitha subjektet.

Në raportin financiar për periudhën janar-shtator 2015, vërehet se në shumë sektor kemi rënie të inkasimit të mjeteve me një rënie të të hyrave vetanake prej rreth 7% nga viti paraprak, tatimi në pronë -2.90%, taksat komunale -19.31% më pak se sa në vitin e kaluar, licencat dhe lejet -26.44%, lejet për ndërtesa -34% kurse kemi ndërtime pa leje në qendër të qytetit të Podujevës, andaj po të merret në përgjithësi kjo tregon se kemi një nivel të ulët të menaxhimit nga ana e qeverisë komunale, pasta të hyra nga qiraja kemi 60,000.00 € në vitin 2015 kurse kjo shumë është planifikuar qysh në vitin 2014, dhe për këtë mendoj se qeveria komunale duhet çdo herë të inkasoj sa më shumë mjete nga të hyrat vetanake e jo të përsëriten shumat e njëjta apo të zvogëlohen ato inkasime gjë e cila mendoj se ndodh si pasoj e një menaxhimi jo të mirë të objekteve në pronësi të Komunës si dhe kjo tregon se kërkesat e opozitës për të debatuar për gjendjen e pronave

publike tregon se është plotësisht e arsyeshme dhe e drejtë. Sa i përket investimeve kemi 66.98% nga buxheti prej 5,228,275.00 € për investime kapitale janë shpenzuar 2,585,792.00 € apo 49.46%, për të cilën mendoj se është një përqindje e vogël kur kemi parasysh kërkesat dhe nevojat e komuniteteve e që pas vizitave të bëra në fshatin Sfeqël, Lagja Reçica ka më shumë se një vit që kanë hartuar dhe dorëzuar projektin por që ende qëndrojnë në gjendje të mjerueshme që e kanë në hyrje të shtëpive të tyre, raste të tilla kemi edhe në lokalitete tjera, mirëpo unë mendoj se projektet e hartuara nga qytetarët duhet të përfshihen menjëherë në prioritete dhe të realizohen, dhe jo të futen projekte të cilat nuk kanë mbulesë buxhetore. Mungesa e një plani të punës tregon edhe një inkasim të dobët të të hyrave vetanake sikurse që tregohet edhe një joseriozitet i punës kur kemi parasysh faktin se në mbledhjen e djeshme të KPF-së prezent ishin vetëm dy drejtor të Drejtorive, ndërsa debatohej një raport financiar i të gjitha Drejtorive, gjë për të cilën mendoj se është mirë që të reflektoj edhe Kryetari i Komunës në mënyrë që performanca e Komunës të del sa më e mirë e që do t'iu gëzoheshim të gjithë. Dëshiroj të ndalem edhe te projektet të cilat ndoshta do të duhej të kishin një arsyeshmëri më të plotë, dhe në këtë aspekt kemi në disa raste shpenzime për udhëtime, mëditje, akomodime etj, e që në parim jemi për këto vizita, por duhet të jenë vizita nga të cilat do të kishte ngritje të performances dhe nga të cilat ne duhet të njoftohemi se cilat janë edhe përfitimet.

Po ashtu mendoj se duhet të kemi specifikime më në detaje sa i përket blerjeve, është kodi 13509 pajisje të tjera, në vlerë 10,818.00 € për të cilat nuk ka specifikime se çka është blerë apo furnizim për zyre në shumë 65,515.00 €, po ashtu kemi të bëjmë edhe me çështjen e druve 103,211.00 €, por që në shumicën e shkollave drutë kanë ardhur me vonesë, gjë për të cilën mendoj se kjo çështje është dashur të përgatitet dhe të sigurohen më herët drutë për ngrohje në mënyrë që shkollat të jenë të përgatitura, sikurse që është mirë që ne si këshilltarë të Kuvendit të jemi në dijeni se sa është çmimi i furnizimit me dru për ngrohje, dhe në këtë aspekt dëshiroj të pyes drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural se personi i cili ka fituar tenderin për furnizim me dru ku e ka mbulesën apo ku i merr drutë, a bënë dëmtim të pyjeve shtetërore apo si është e rregulluar kjo çështje, e them këtë ngase gjatë vizitave që kemi pasur në terren sidomos në rrethinën e fshatit Pollatë ka ankesa të shumta si pasoj e dëmtimit të pyjeve. Gjithashtu çështje tjetër është edhe pagesat për dreka zyrtare për të cilat jemi në parim mirëpo duhet ta dimë se me cilin delegacion, si, dhe qysh, të specifikohen dhe mos të ndodh që vetëm të paraqitet një shumë. Çështje tjetër ka të bëjë me emërtimin e shkollës në fshatin Shajkoc për të cilin kam vërejtje sepse ende figuron emërtimi vjetër shkollës që ka qenë “Elena Gjika”, kurse në të vërtetë ka më shumë se dhjetë vite që ajo shkollë është emërtuar “Hasan Ramadani”. Në shumë shkolla kemi shpenzime komunale bukur të mëdha por megjithatë shkollat kanë mungesë, shembull, aty ku unë punoj ka mungesë të infrastrukturës sportive duke mos përjashtuar edhe mungesën e topave sportiv e që kjo tregon gjendjen e shkollave tona. Në vazhdim dëshiroj të ceku pagesat që janë bërë në vitin 2015 për të cilat në rast se ndalemi dhe i analizojmë në mënyrë të detajuar sigurisht se do të vërejmë se shumë projekte i janë dhënë vetëm një firme madje më shumë se 20 herë, firma për të cilat mendoj se janë të afërta me pushtetin, e që ne jemi kundër kësaj, shembull, kemi gjendjen e mbrëmjeve të maturës së shkollave të mesme të cilave iu është imponuar të shkojnë në një restorant i cili është i afërt me partinë në pushtet.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, nënvizoi, pas deklarimit të shefave të Grupeve të këshilltarëve, unë e hapë debatin për këshilltarët tjerë të Kuvendit, pastaj kemi drejtorët e Drejtorive për sqarime, arsyetime dhe përgjigje të ndryshme.

znj.Endritë Murati, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës e kemi analizuar raportin financiar për periudhën janar – shtator 2015 në të cilin kemi vërejtur disa ulje dhe ngritje të shpenzimeve. Sa i përket uljes së shpenzimeve në disa kode e përgëzojmë Komunën e Podujevës, me përjashtim shpenzimeve në kodin 13630, furnizimet mjekësore, që në vitin 2014 ishin 14,394.00 € shpenzime, ndërsa në këtë vit janë shpenzuar vetëm 6,365.00 €, andaj shtohet pyetja, përse është bërë kjo rënie e shpenzimeve në kodin e cekur kur kemi parasysh se nevojat për rritje të shpenzimeve në këtë kod janë shumë të mëdha, pastaj për derivate për gjenerator kemi një rritje të shpenzimeve prej 131%, apo shpenzime në shumë 7,554.00 € në këtë vit kurse në vitin 2014 shpenzimet për derivate për gjenerator ishin 3,268.00 €, mandej pagesat për rrymë është rritur për 25,000.00 € më shumë se në vitin 2014. Po ashtu përshtypje na ka bërë shuma prej 822.00 € e shpenzuar për shërbime postaren në vitin 2015, kurse në vitin 2014 shpenzimet në këtë kod ishin vetëm 10 €. Kodi 13509 pajisje tjera, për të cilat nuk specifikohet se për çfarë pajisjesh bëhet fjalë, është një rritje të shpenzimeve për 21%. Për regjistrimin e automjeteve kemi një rritje të shpenzimeve për 96%, sikurse që ka rritje edhe për sigurimin e tyre për 83%, shpenzime të cilat në vitin 2014 kishin shumën 4,374.00 € kurse në vitin 2015 shuma është 8,009.00 €, andaj shtroj pyetje përse është kjo ngritje kaq e madhe. Gjithashtu kemi shpenzimet për reklama dhe konkurse në shumë 100.00 €, kurse në vitin 2014 për këtë çështje shpenzoheshin 2,369.00 € që i bie 95% rënie, gjë për të cilën mendoj se kjo është arsyeja pse qytetarët e Komunës së Podujevës ankohen për mos informim.

z.Flakron Gashi, theksoi, ne dëgjuam z.Fidan Rekaliun i cili e tha se raporti financiar është në harmoni me ligjin, unë mendoj se tamam puna të mos ishte në harmoni me ligjin si koncept ajo çfarë na ofrohet neve këshilltarëve të Kuvendit, mirëpo unë i them kolegut se në këtë raport ka gjëra që janë përfshirë në këtë raport dhe të cilat sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe dokumenteve tjera mund të del që raporti nuk është në harmoni me ligjin ashtu siç u përshkua nga këshilltari i cekur. Çështjet të cilat do t'i ngris në vazhdim vlejné për drejtorët e Drejtorive; z.Isuf Latifi e tha se 66.98% është realizuar ajo çfarë është paraparë në buxhet, dhe nëse shikohet kjo përqindje deri në muajin shtator, atëherë mund të thuhet se Komuna e Podujevës është duke ecur mirë në këtë aspekt, mirëpo kjo përqindje është ngritur nga kategoria paga dhe mëditje, dhe kategoria e shpenzimeve komunale, ndërsa ajo që është për tu shqetësuar dhe që në fakt paraqet dobësitë e menaxhimit të mirëfilltë të qeverisjes në Komunë është se për investime kapitale, nga ajo që është planifikuar, janë realizuar vetëm 46.49%, dhe në kategorinë subvencione dhe transfere janë realizuar vetëm 58.06%, andaj mendoj se kjo përqindje është jashtë çdo norme ngase kanë kaluar nëntë muaj dhe Komuna ka realizuar vetëm gjysmën e buxhetit. Gjithashtu te kategoria e të hyrave vetanake ku nga shuma 1,597,592.00 €, sa ishte për vitin 2015, janë realizuar vetëm 53% e atij buxheti dhe duke qenë në dijeni se raporti financiar është për periudhën nëntëmuajore, del se një pjesë bukur e madhe e projekteve që kanë qenë të mbuluara nga kategoria e të hyrave vetanake ose do të dështojnë ose do të ishte mirë që drejtorët e Drejtorive të na tregojnë se nga cilat kategori do të mbulohen ato planifikime. Po ashtu jemi në dijeni se investimet në projektet kapitale nuk janë në hap dhe në ritëm me muajt, këtë e them duke pas

parasysh se tani jemi në muajin e njëmbëdhjetë dhe veç kanë filluar reshjet e shiut dhe të borës, a do të mund të realizohen deri në fund të vitit projektet e planifikuara, dhe duke qenë në dijeni se buxheti i parashikuar nga grantet qeveritare nëse nuk realizohet kthehet mbrapa dhe me keqardhje e them që besoj se Komunës do i ngelen shumë projekte të porealizuara. Çështje tjetër e cila paraqet shqetësim është Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ku nga shuma rreth 380,000.00 € sa ishin të planifikuara për projekte kapitale në buxhetin e vitit 2015, janë realizuar vetëm 146,000.00 € apo 54%, sikurse që paraqet shqetësim edhe Drejtoria e Arsimit ku nga shuma prej 196,000.00 € janë realizuar vetëm rreth 54,000.00 € apo 27%, prandaj mendoj se kjo dëshmon edhe njëherë se nuk ka një fleksibilitet dhe nuk është duke ecur në hapa dhe në parametra të asaj që është votuar në këtë Kuvend të Komunës dhe projektet e parapara.

Gjithashtu shqetësuese është që përveç projekteve të votuara të cilat sigurisht se nuk do të mund të realizohen dhe që ka ngecje në hapat e tyre, del që realizohen edhe projekte të cilat nuk janë votuar nga ky Kuvend i Komunës e që sipas ligjit përkatës Ekzekutivi i Komunës nuk mund të shpenzoj mjete pa vendim të Kuvendit të Komunës.

znj. Adelinë Stublla, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të Lëvizjes Vetëvendosje dje kemi qenë në një vizitë në Lagjen e Dëshmorëve ku kemi biseduar me disa nga kryefamiljarët e shtëpive të sapondërtuara dhe ato familje të cilat që prej gjashtë muajve që janë vendosur nuk janë vizituar asnjëherë nga autoritetet komunale, ato familje kishin kërkesa të shumta duke filluar nga dalja e ujërave të zeza në sipërfaqe dhe që kundërmonte një erë e rëndë dhe ishte pengesë për hapjen e dritareve të atyre shtëpive, pastaj dëmtimi i pusëtës afër shtëpive gjë që rrezikonte nxënësit dhe banorët përreth, po ashtu rrjedhja e ujërave në oxhakët e shtëpive në dhoma si pasojë e reshjeve të shiut, si dhe disa probleme tjera lidhur me energjinë elektrike dhe me mungesë të ujit. Duke u bazuar në të gjitha këto që i ceka mendoj se duhet të ndërmerret diçka e mirë për ata banorë.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, parafolësja i paraqiti disa shqetësime të vetat, mirëpo tema për të cilën ajo foli ishte jashtë temës së paraparë me rend të ditës, por sido që të jetë e falënderoj, tani fjalën e kanë drejtorët e Drejtorive të cilët dëshirojnë të japin përgjigje, sqarime dhe arsyetime të nevojshme për çështjet e ngritura nga këshilltarët parafolës.

z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, theksoi, kërkoja fjalën me qëllim që t'i jap disa sqarime dhe disa përgjigje rreth disa çështjeve të ngritura nga parafolësit, do të filloj me atë të z. Haki Rudarit që ka të bëjë me projektin e Lagjes Reçica nga fshati Sfeqël, është e vërtetë se ai projekt është dorëzuar në Drejtori përmes protokollit por nuk ka më shumë se një vit ashtu siç u tha, ekziston dosja edhe në Zyrën e pranimi dhe është projekti i fundit që është dorëzuar nga fshati Sfeqël.

Unë i garantoj të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës dhe të gjithë këshilltarët e Kuvendit se i gjithë plani dinamik i propozuar nga ne dhe i miratuar nga Kuvendi i Komunës, në përpikëri është duke u realizuar brenda afateve kohore, dhe në këtë aspekt jam shumë transparent andaj secili që është i interesua për ndonjë çështje, lirshëm mund të drejtohet në Zyrën ku unë punoj dhe unë do të jem i gatshëm t'ju përgjigjem në çdo kohë. Ju rikujtoj se ne e bëjmë hartimin e planit dinamik të cilin pastaj e dorëzojmë në Zyrën e prokurimit në muajin tetor të çdo viti për vitin pasues kështu që besoj se jemi në rrugë të mirë sa i përket realizimit të planifikimeve tona për vitin 2015.

z.Avni Ajeti, theksoi, parafolësja znj.Adelina Stublla, në diskutimin e saj ceku përmendi disa çështje që kanë të bëjnë me banorët e Lagjes së Dëshmorëve në fshatin Balloc, unë konsideroj se nuk qëndrojnë ato që u cekën sepse ne disa herë së bashku me drejtorin e Drejtorisë përkatëse kemi vizituar Lagjen e Dëshmorëve dhe ato çështje të cilat i përmendi këshilltarja e cekur, neve nuk na janë thënë asnjëherë nga banorët.

z.Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, theksoi, do të mundohem t'i jap disa sqarime për disa çështje të cilat u ngritën nga disa parafolës edhe pse nuk ishin temë e diskutimit sot. Për Drejtorinë e Arsimit në Komunën e Podujevës është shumë me rëndësi që rreth 22000 nxënës vijnë në procesin e mësimi dhe mbi 90% e tyre nuk kanë kurrfarë problemesh në këtë aspekt, mirëpo janë rreth 10% të nxënësve të cilët ballafaqohen me probleme të natyrave të ndryshme, mirëpo nuk qëndrojnë ato që u thanë nga z.Rafet Llapashtica dhe disa këshilltarë tjerë, sepse çështja që ka të bëjë me normën e mësimdhënësve nuk është diçka që caktohet nga Drejtoria e Arsimit por normat e mësimdhënësve caktohen në bazë të paraleleve të cilat formohen në bazë të ligjit, po edhe nëse ju ka dhënë ndonjë mësimdhënësi normë me dhjetë orë sigurisht se pagesa i bëhet për dhjetë orë, pra nëse rritet numri i nxënësve shtohen paralelet dhe shtohen normat. Po ashtu jeni në dijeni se në disa vende rurale kemi shkolla me numër të vogël të nxënësve mirëpo ne jemi të obliguar t'i mbajmë ato shkolla dhe kjo mund të ndikoj në formim të paraleles por kjo nuk është për ne shqetësuese. U përmend çështja që kishte të bënte me një mësimdhënëse, znj.Shukrie Zhitija, për të cilën Inspeksioni i arsimit ka nxjerrë një vendim por që Drejtoria e Arsimit nuk është pajtuar me atë vendim dhe i njëjti është kundërshtuar dhe lënda ka shkuar në Gjykatë. Po ashtu për Drejtorinë e Arsimit është mjaft me rëndësi që për 65 objekte shkollore me 40 shkolla amë, është siguruar lënda djegëse, drutë, thëngjilli, nafta dhe peleti në shkollat e reja, vlen të ceket se në shkollën ku punon z.Haki Rudari me kohë janë bërë përgatitjet dhe është siguruar lënda djegëse dhe funksionimi i sistemit të nxemjes së asaj shkolle, krejt kjo është bërë sipas ligjit, pra të gjitha përgatitjet në përgjithësi janë bërë me kohë dhe atëherë kur është vlerësuar se duhet të lëshohen nxemjet nëpër gjitha shkollat janë lëshuar, ku edhe vetë personalisht i kam vizituar shumicën prej tyre. U përmend edhe çështja që ka të bëjë me rrënimin e objektit të vjetër të shkollës “Naim Frashëri”, çështje për të cilën ju them se Drejtoria e Arsimit nuk i përcakton rregullat dhe çmimet, por është ligji i prokurimit ai i cili përcakton këto rregulla, ndërsa rrënimi i objektit të vjetër të asaj shkolle konsideroj se ka qenë i nevojshëm për arsye se është ndërtuar objekti i ri dhe në hapësirën e objektit të vjetër kemi ndërmend ta rregullojmë me ulëse, gjelbërim dhe të tjera, fillimisht kemi pasur një problem rreth inventarit të ri mirëpo bashkërisht me Ministrin e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë kjo çështje është rregulluar dhe tani pritet vetëm pranimi teknik nga ana e Komisionit European në mënyrë që shkolla “Naim Frashëri” të filloj procesin e mësimi në objektin e ri, është e vërtetë se nxënësit e kësaj shkolle kanë humbur rreth dy javë mirëpo besoj se ato orë do të kompensohen. Sa i përket emrit të shkollës në fshatin Shajkoc, unë nuk jam në dijeni pse ka mbetur ashtu, por konsideroj se kjo ka të bëjë vetëm me çështje teknike ngase në dokumentacione përkatëse të shkollës figuron emërtimi “Hasan Ramadani”. Unë personalisht jam i kënaqur me funksionimin e shkollave të Komunës së Podujevës, mirëpo mendoj se problemi kryesor qëndron në cilësinë e arsimit nga ana e mësimdhënësve, dhe në këtë aspekt duhet të ndalemi të diskutojmë dhe të analizojmë se çka mund të bëjmë ne por jemi të vetëdijshëm se mësimdhënësit janë ata të parët të cilët mund ta rrisin cilësinë e arsimit dhe në këtë aspekt dëshiroj të marrë vetëm një shembull,

para pak ditësh kam vizituar një shkollë, që nuk dëshiroj të ceku se cilën, në të cilën më parë ishte krijuar një ambient duke menduar se duhet të punohet “vetëm kështu”, mirëpo për fat të mirë para tre muajve në atë shkollë është punësuar një mësuese e cila në atë mes ose ambient ka ndërruar për të mirë gjithë disponimin dhe qasjen e nxënësve dhe personelit të asaj shkolle, informacione të cilat i mora nga nxënësit dhe për këtë jam shumë i kënaqur. Prandaj për ne tani e tutje çështje prioritare do të jetë ngritja e cilësisë.

znj. Adelinë Stublla, theksoi, e falënderoj kolegun z. Avni Ajetin, i cili edhe pse e tha se ne kemi vizituar Lagjen e Dëshmorëve, familjarët e asaj Lagjeje nuk na kanë njoftuar neve për këtë gjë, kurse sa i përket gjërave të cilat i përmenda në diskutimin tim të mëparshëm, ju them se ne nuk i kemi shpikur ato gjëra por janë vetë familjarët e Lagjes së Dëshmorëve përkatësisht familjarët e shtëpive të reja që i kanë shprehur ato gjëra, kështu që mund t'i vizitoni dhe sigurisht se do t'ju thuhet edhe juve të njëjtat gjëra.

z. Haki Rudari, theksoi, çështja që ka të bëjë me fshatin Sfeqël për të cilën foli edhe drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, unë ju them se tani në kohën e dimrit është vështirë të udhëtohet në drejtim të shkollës, dhe për këtë kurdo që dëshironi mund të vizitohet atë që e ceke më parë. Çështja tjetër, drejtori i Drejtorisë së Arsimit e tha se mbi 90% e nxënësve të Komunës së Podujevës vijojnë procesin e mësimi, por u mendoj se në qoftë se vetëm një nxënës nuk vijon mësimin, ne duhet të brengosemi. Sa i përket ngritjes së cilësisë nga ana e mësimdhënësve, unë e përkrahi këtë, mirëpo konsideroj se ngritja e cilësisë nuk mund të bëhet duke zgjedhur drejtor me bindje politike dhe duke pranuar kuadro nga turizmi-bregdeti, nga Prishtina etj. andaj në këtë mënyrë nuk shkohet përpara duke pranuar kuadro politik. Sa i përket emrit të shkollës së fshatit Shajkoc, ka disa vite që ish emërtimi i shkollës “Elena Gjika” figuron në dokumentacione dhe në hyrje të shkollës, dhe kjo çështje është problem që duhet të rregullohet nga Drejtoria e Arsimit. Kolegu këshilltar z. Avni Ajeti e tha se nuk qëndrojnë ato që u than rreth Lagjes së Dëshmorëve, mirëpo ja rikujtoj atij se ne dje ishim në vizitë, dhe kërkesat e atyre familjeve ishin ato që u than, dhe për të vërtetuar këtë ne mund të vizitohet bashkërisht dhe do të shohim se kanalizimi kishte dalë përmbi tokë.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, nuk dëshiroj të bëjë replikë me drejtorin e Drejtorisë së Arsimit rreth çështje së vendimit të Inspektoratit të Arsimit për të cilin drejtori e tha se për ne ka qenë i papranueshëm, unë e them se Inspektorati i arsimit është autoritet më i lartë se drejtor i një Drejtorie të Arsimit, dhe nëse dëshironi mos e zbatoni atë vendim, por jam i sigurt se jeni të obliguar të zbatoni një vendim të një autoriteti më të lartë, ju si drejtor jeni në dijeni për shkeljen që është bërë dhe atë shkelje nga mosdija mund ta bënë secili, por ekziston mundësia e përmirësimit apo mundësia tjetër është që duhet të zhvillohen procedura. Sa i përket gjendjes së arsimit, drejtori do të ishte mirë të tregonte sa kohë nuk kanë vijuar procesin e mësimi nxënësit e fshatit Surdull, gjithashtu sa i përket shkollës “Naim Frashëri” e cila ka rreth 1200 nxënës konsideroj se po që se vetëm dy ditë nuk zhvillohet procesi i mësimi ju si drejtor nuk keni mundësi operacionale të kompensoni ato ditë dhe ato orë mësimi sepse të gjithë prindërit e atyre nxënësve nuk mundin që për një neglizhencë tuajën, të dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë vikendeve, andaj kjo është një përgjegjësi e cila i takon secilit drejtor të Drejtorisë së Arsimit, si të tanishëm si të ardhshëm, po ashtu planin dinamik të kompensimit të orëve të humbura duhet ta prezantoni ju si drejtor, nëse e keni, Prandaj nuk mund të themi se gjendja është e mirë. Pastaj kemi të bëjmë me emërime politike ku të gjithë ne e kemi kuptuar se program i subjekteve politike është ardhja në qeverisje dhe qeverisja me njerëz të tyre,

por ajo qeverisje dhe ata drejtor të shkollave duhet të punojnë mirë, nuk jam kundër emërimeve të drejtorëve të caktuar në shkolla, por ata drejtor duhet të punojnë mirë, pasta dy-tri shkolla janë ende të pa emërtuara, kurse shkollën e re e keni emërtuar “Ibrahim Rugova” pa marrë vendim Kuvendi i Komunës, dhe po të na propozohet një propozim i tillë ne sigurisht se do ta mbështetnim, shtroj pyetje, me çfarë emërtimi të asaj shkolle dhe si do të shtypni diplomat, dëftesat dhe librezat e rezultateve të nxënësve të asaj shkolle kur dihet se vendim të Kuvendit për emërtimin e asaj shkolle nuk ka, e bëra pyetjen duke u mbështetur në atë se vendimin përkatës duhet ta marrim ne si Kuvend i Komunës, andaj në këtë aspekt nuk di si mund të mban peng një drejtor i Drejtorisë së Arsimit një shkollë të re me rreth 2000 nxënës me një toponim të një figure dhe nuk e merr një hap i cili do të ishte propozim në Kuvendin e Komunës. Gjithashtu kemi ndërtimin e kanalizimit në fshatin Revuç ku është shtruar vazhda dhe është situacioni 2 tani duke vazhduar, kurse pas dy muajve i gjithë ai kanalizim është bllokuar dhe të gjitha ujërat e zeza kanë dalë në sipërfaqe dhe nuk është ndërmarrë asgjë. Po ashtu është krijuar një parim ku drejtorët e Drejtorive na thonë, kushdo që është i interesuar mund të vijë në zyrë të shikon të gjithë dokumentacionin, gjë e cila për mua nuk është e rëndësishme dhe e arsyeshme sepse situata në terren është reale dhe shihet.

z.Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, theksoi, nuk kam ndërmend të bëjë replikë me askënd, mirëpo lidhur me emërtimet e dy shkollave që u cekën dëshiroj të jap sqarimet e nevojshme në mënyrë që mos të kemi dilema rreth kësaj çështjeje. Shkolla e fshatin Shajkoc ka herë është emërtuar “Hasan Ramadani” dhe të gjitha dokumentet duke përfshirë edhe vendimin janë në gjendje të rregullt përveç në shabllonet e Ministrisë së Financave në të cilët ende figuron emërtimi i vjetër i shkollës, gjë për të cilën ne disa herë kemi bërë kërkesë për rregullimin e asaj çështjeje por arsyetimi i tyre ka qenë se pastaj duhet të ndërrohen shumë gjëra dhe për këtë kërkohet shumë punë, përndryshe asnjë problem tjetër me këtë emërtim nuk ka, qoftë në dëftesa qoftë në librezat shkollore të nxënësve e të tjera. Sa i përket shkollës “Dr.Ibrahim Rugova”, është një Udhëzim Administrativ i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë i cili rregullon procedurat e emërtimit të një institucioni arsimorë, Udhëzim i cili nga ana jonë është zbatuar dhe respektuar në përpikëri ku sipas tij Këshilli i shkollës bënë propozime të cilat pastaj i sjellë në Drejtorinë e Arsimit, dhe mandej Drejtoria e Arsimit ato propozime i dërgon në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë e cila është autoritet final për emërtimin e një institucioni arsimorë në Republikën e Kosovës, pra shkolla e cekur pothuajse ka një vit që e ka marrë Vendimin e nënshkruar nga Ministri i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë me të cilin është emërtuar “Dr. Ibrahim Rugova” .

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, me që diskutimet pothuajse përfunduan rreth kësaj pike të rendit të ditës, mua më mbetet vetëm të hedhë në votim raportin financiar të Komunës së Podujevës për periudhën janar – shtator 2015.

Pas votimit u konstatua se me 19 vota për, 12 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur, miratohet raporti financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar – shtator 2015.

4. Propozim vendimet për ndërrimin e destinimit të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (sipas kërkesave të Valon Isak Kastratit nga fshati Kërpimeh dhe Hazir Mehmet Sylës nga fshati Gllamnik)

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kemi dy propozim vendime për ndërrimin e destinimit të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, njëri është sipas kërkesës së Valon Isak Kastratit nga fshati Kërpimeh, kurse propozimi tjetër është ai i cili me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa u votua si pikë shtesë në kuadër të rendit të ditës përkatësisht në kuadër të pikës së katërt të rendit të ditës.

z.Flakron Gashi, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e subjektit PDK, në parim gjithherë i kemi përkrahur kërkesat e tilla me një konsensus të përgjithshëm, sepse fundja e drejta e pronës është e patjetërsueshme dhe secili ka të drejtën që sipas disponimit ta përdorë pronën e tij, mirëpo kjo praktikë është shpeshtuar që në momente të fundit të vijnë kërkesa apo propozim vendime të reja, dhe për këtë çështje kam pyetje konkrete për drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit z.Durim Salihu, a ka kërkesa të tjera pran Drejtorisë suaj për të njëjtën çështje, e them këtë sepse thuhet se janë duke u bërë selektime në baza jo të rregullta për çka qytetarët kanë edhe ankesa, çështje për të cilën konsideroj se nuk është mirë që të ketë vonesa dhe selektime të tilla, kurse në parim ne i mbështesim këto propozim vendime.

z.Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, theksoi, sa i përket pyetjes që parafolësi e parashtroj, përgjigja është kjo, po ka edhe kërkesa tjera për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore qoftë për zonën urbane të qytetit qoftë për zona rurale, ligji përkatës i definon shumë qartë se klasa 1-4 e tokës bujqësore mund të shëndrrohet në tokë ndërtimore vetëm për ato objekte të cilat janë të karakterit të zhvillimit të bujqësisë dhe blegtorisë, në këtë aspekt janë refuzuar disa kërkesa të cilat kanë qenë për toka bujqësore të klasës së parë dhe të destinuara për ndërtesa të banimit, pra janë refuzuar sepse më është dashur të veprojmë sipas ligjit. Sa i përket propozimeve të cilat i keni paravetës kanë të bëjnë me përfitues të granteve nga niveli qendrorë dhe çka është më e rëndësishmja se këta persona kanë afat të shkurtë për dorëzimin e dokumentacioneve përkatëse në Ministri, duke përfshirë pëlqimin e Drejtorisë për lokacionin i destinuar për ndërtim, kurse mbetet e juaja a dëshironi të miratoni këto kërkesa apo jo.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, besoj se u dhanë sqarimet e nevojshme rreth këtyre kërkesave, andaj i hedhë në votim të përbashkët këto dy propozim vendime.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratuan këto propozim vendime, përkatësisht;

1-Propozimi i vendimit për ndërrimin e destinimit të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore - sipas kërkesës së Valon Isak Kastratit nga fshati Kërpimeh, dhe

2-Propozimi i vendimit për ndërrimin e destinimit të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore - sipas kërkesës së Hazir Mehmet Sylës nga fshati Gllamnik.

5. Të Ndryshme

z.Flakron Gashi, theksoi, gjatë kësaj mbledhjeje pati diskutime rreth arsimit në Komunën e Podujevës dhe u përmend rasti i znj.Shukrije Zhitjes, por nuk është vetëm rasti i të përmendurës që Inspektorati i arsimit e njehë të drejtën në ankesë, e njëjta ka ndodhë edhe me znj.Fatbardha Hoti, fjala është për rastin e shkollës “Nuhi Gashi” në fshatin Bradash, andaj meqë rastet e tilla janë shpeshtuar konsideroj se do të ishte e rrugës dhe do të ishte mirë që në një seancë të ardhshme të ketë një pikë të veçantë të rendit të ditës, në të cilën do të mund t’i ballafaqonim të gjitha argumentet për ose kundër, dhe që Drejtoria e Arsimit të del me një qëndrim konkret sa i përket keqpërdorimeve në Drejtorinë e Arsimit, e që unë mendoj se ka raste të keqpërdorimeve të ndryshme.

z.Haki Rudari, theksoi, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, gjatë bashkëbisedimeve me qytetarë të ndryshëm, më janë paraqitur ankesa të cilat kanë të bëjnë me vendosjen e njehsorëve të energjisë elektrike në pozita të ulta nga sipërfaqja e tokës, andaj jam i interesuar të di se a ka leje nga ana e Komunës apo si është e rregulluar kjo çështje.

Pasi më nuk pati të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi mbledhjen të përfunduar.

Mbledhja përfundoi në orën 11;30

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-006-99939
Podujevë,
25 nëntor 2015**

**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**